



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 75, Datë 13.04.2022

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2022**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimet e bordit nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 486/4 prot., datë 11.04.2022, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Janar-Shkurt-Mars 2022”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën e saj nr. 631 prot., datë 01.02.2022, paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 32.75 lekë/kWh për muajin Janar 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Me shkresën nr. 728 prot., datë 04.02.2022, shoqëria FSHU sh.a. paraqiti në ERE, aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18.8 lekë/kWh për muajin Janar 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- ERE me shkresën nr. 213/1 prot., datë 15.02.2022, ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të paraqesë përlllogaritjet e saktësuara të kostove administrative për vitin 2022, të cilat lidhen me kryerjen e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, duke i ndarë ato nga kostot direkte të FSHU sh.a., në mënyrë të tillë që këto kosto të alokohen në mënyrë korrekte ndaj klientëve fundorë, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 6, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”. Gjithashtu, ERE ka kërkuar paraqitjen e pasqyrave të plota financiare të shoqërisë për vitin 2021, duke evidentuar në formë analitike të ardhurat dhe shpenzimet operative të FSHU sh.a., të ndara nga ato që shërbejnë për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

- ERE me shkresën nr. 266 prot., datë 15.02.2022, i është drejtuar shoqërisë KESH sh.a. dhe ka vënë për dijeni MIE-n dhe FSHU sh.a., duke kërkuar plotësim informacioni dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit sipas përcaktimeve të VKM-së nr.244, datë 30.03.2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar.
- Në vijim të përgjigjes së ardhur me shkresën nr. 939/2 prot., datë 23.02.2022, nga shoqëria KESH sh.a., bashkëlidhur së cilës është Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit nr. 1349/1, datë 16.02.2022 “*Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2022 dhe parashikimi 2023-2026*” dhe në pikën 1, të këtij vendimi përcaktohet se: “*çmimi i shitjes së energjisë elektrike për FMF-klientë tariforë do të jetë 12 lekë/kWh*”, ERE i është drejtuar me kërkesë për interpretim shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me sasinë e blerë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF”.
- ERE me shkresën nr. 213/2 prot., datë 28.02.2022, ka kërkuar paraqitjen e aplikimit për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët të cilët shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, në përputhje me përcaktimet e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, e ndryshuar, si dhe vendimit të bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020. Kjo kërkesë i është drejtuar shoqërisë FSHU sh.a., duke patur parasysht se:
  - Në komunikimet e paraqitura nga shoqëria, bashkëlidhur aplikimit për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin Janar 2022 për klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, KESH sh.a. pritet të vendosë në dispozicion sasinë e energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve që shërbehen në kushtet e mundësisë së fundit me çmimin për njësi prej 12 lekë/kWh;
  - Neni 8, i Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, e ndryshuar, përcakton se llogaritja e Çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit kryhet bazuar në “CBET” çmimin mesatar të ponderuar të profileve të blerjes për sasinë e energjisë së siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi.
  - Bordi i ERE-s me anë të vendimit nr. 252, datë 21.12.2021, vendosi ndër të tjera të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a. për tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022. Në vendimin e Bordit të ERE nr. 213, datë 15.12.2020, është parashikuar se në kushtet e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe të drejtës

të klientëve fundorë për të zgjedhur lirisht furnizuesin e tyre për furnizimin me energji elektrike, për të gjithë klientët e tjerë fundorë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tjera të tensionit, të cilët nuk kanë një tarifë të miratuar nga ERE, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të faturojë energjinë e lëvruar bazuar në tarifën mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike prej 4.79 lekë/kWh, të miratuar nga ERE.

- Shoqëria KESH sh.a. me shkresën nr. 1513/3 Prot, datë 28.03.2022, në kuadër të nevojës për saktësimin e përcaktimeve të akteve që rregullojnë marrëdhëniet mes shoqërisë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE”, Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të KESH sh.a. nr. 2612/1, datë 25.03.2022, ku miratohet se në tabelën pjesë e vendimit 01, date 19.01.2022, të Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a, në të cilën thuhet: *“çmimi i shitjes për klientët tariforë të FMF – klientë tariforë” saktësohet në “çmimi i shitjes për klientët tariforë të FMF – klientë tariforë të furnizuar në nivel tensioni deri 20 KV”.*
- Lidhur me gjithë sa më sipër, shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 1395/2 prot., datë 31.03.2022, i është përgjigjur vetëm kërkesës së ERE mbi saktësimin e sasisë së blerë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF, ndërsa përsa i përket kërkesave të tjera të ERE-s mbi problematikat e konstatuara në aplikimet e paraqitura për miratim, ende nuk ka një përgjigje nga ana e FSHU sh.a.
- Në shkresën e sipërcituar, shoqëria FSHU sh.a. deklaron se: *“..Për sa më sipër, në kushtet kur sasia e energjise e blerë nga KESH SH.A. me çmimin 12 lekë/kWh ka shërbyer vetëm për klientët FMF të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV, për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF 35 kV FSHU SH.A. ka siguruar energjinë elektrike në treg të lirë. Në varësi të çmimit të blerjes së energjisë elektrike, si dhe bazuar në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë Së Fundit”, miratuar me Vendimin e ERE nr. 201/2017, i ndryshuar, ka rezultuar çmimi i diferencuar për të dyja kategoritë FMF 35 kV dhe 6/10/20 kV, për të cilat është kryer aplikimi për miratim pranë ERE”.*
- Në kushtet e saktësimit nga ana e shoqërive KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., mbi sasinë e energjisë elektrike të shitur shoqërisë FSHU sh.a. për furnizimin me energji elektrike për klientët që shërbehen nga FMF, ERE me qëllim miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajt janar-shkurt-mars 2022, vlerëson që deri në paraqitjen e kostove administrative të cilat i shërbejnë shoqërisë FSHU sh.a. për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, të vijojë të përdorë koston administrative prej 1.79 lekë/kWh për llogaritjen e çmimit të energjisë elektrike të FMF për muajt janar-shkurt-mars 2022.
- Kosto administrative për muajin janar 2022, deri në paraqitjen e informacionit të kërkuar nga ERE, do të vijojë të jetë në të njëjtën vlerë si viti i kaluar, prej 1,79 lekë/kWh.

- Me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021, bordi i ERE-s ndër të tjera vendosi:
  - Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022”, e cila është 0.75 lekë/kWh.
  - Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, të bordit të ERE, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 233, datë 19.11.2021, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2022”, të cilat do të jenë:
    - tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV do të jetë 1,5 lekë/kWh
    - tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 20 kV do të jetë 3,9 lekë/kWh
    - tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes do të jetë 4,79 lekë/kWh.
- Në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, e ndryshuar, aplikimeve të FSHU sh.a., si dhe llogaritjeve të ERE-s, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Janar 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse si më poshtë vijon:

*Sipas Përllogaritjeve të ERE Çmimi i FMF-së për muajin Janar 2022 sipas Niveleve të Tensionit*

		Nivelet e tensionit		
		35 kV	20 Kv	10/06 kV
	<b>Njësia</b>			
CBEt	të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	27.88	12.00
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.84</u>	<u>0.36</u>
Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante		Leke/kWh	28.72	12.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	4.79
<b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA</b>		<b>Leke/kWh</b>	<b>32.76</b>	<b>18.80</b>
			<b>18.80</b>	<b>19.69</b>

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Janar 2022 do të jetë:
  - 32.76 Lekë/kWh për klientët FMF në nivelin e tensionit 35 kV;
  - 18.80 Lekë/kWh për klientët FMF në nivelin e tensionit 20kV;
  - 19.69 Lekë/kWh për klientët FMF në nivelet e tensionit 10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Janar 2022, prej:
  - 32.76 Lekë/kWh për klientët FMF në nivelin e tensionit 35 kV;
  - 18.80 Lekë/kWh për klientët FMF në nivelin e tensionit 20kV;
  - 19.69 Lekë/kWh për klientët FMF në nivelet e tensionit 10/6 kV.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**